



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 619 Prot.

Tiranë, më 14.09 2015

VENDIM Nr. 102, datë 1.09.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 42, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, të datës 1.09.2015, pasi shqyrtoi *Relacionin shpjegues* në lidhje me kryerjen e mbikëqyrjeve arkeologjike të punimeve të zbatimit të projekteve, paraqitur nga ASHA,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Relacionin shpjegues* në lidhje me kryerjen e mbikëqyrjeve arkeologjike të punimeve të zbatimit të projekteve, paraqitur nga ASHA.
- II. Për ato projekte zhvillimore për të cilat, *KKA i delegon DRKK-së përkatëse kryerjen e mbikëqyrjes arkeologjike të zbatimit të punimeve, DRKK të jetë palë nënshkruese e aktmarrëveshjes që do të lidhet për këtë qëllim*, midis Investitorit, DRKK dhe ASHA, në të cilën do të parashikohen të detajuara detyrimet e palëve.
- III. DRKK do të dërgojnë zyrtarisht çdo proces-verbal të mbajtur në terren pranë ASHA, duke mundësuar në këtë mënyrë përditësimin e informacionit në formën zinahir, gjë që do t'i shërbejë drejtpërdrejt procesit të monitorimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FLURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO